

Bursa e Ekselencës Akademike

Dr. Jorgji Jajçari

Edicioni V

Kush mund të aplikojë?

Bursa do t'i akordohet një nxënësi nga rrethi i Pogradecit që është duke ndjekur klasën IX dhe në vitin shkollor 2023-2024 do të jetë në vitin e parë të gjimnazit. Bursa është e vlefshme për të mbuluar \$1,000 të tarifës së mësimdhënies në shkollën Nehemia për klasën X. Aplikimet hapen në datën 15 mars 2023 dhe mbyllen në datën 15 maj 2023.

Kriteret bazë për aplikuesit:

1. Të jetë duke ndjekur klasën e nëntë.
2. Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të ketë notën mesatare mbi 9.00 gjatë të gjitha viteve.
4. Të ketë marrë pjesë në aktivitete vullnetare në shërbim të komunitetit.
5. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze. Njohja e gjuhëve të tjera të huaja është përparësi.
6. Nxënësit fitues nëpër aktivitete akademike si konkurse apo olimpiada të organizuara në nivele të ndryshme (në bazë shkolle, qyteti, rrethi, kombëtare e më tutje) kanë përparësi.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- CV personale (të limitohet në jo më shumë se dy faqe). Për detaje mbi formatin e CV, vizitoni www.LyhnidaFund.com
- Fotokopje e dëftesave të klasave V, VI, VII, VIII. Lista e notave për simestrin I, klasa IX.
- Zhvillimi i një eseje argumentuese në anglisht, me të paktën 300 fjalë. Zgjidhni një nga tre temat e mëposhtme (krijimi duhet të jetë personal; çdo formë plagjature do të shkaktojë squalifikim automatik të kandidatëve):
 - *Is it better to be born rich or smart?*
 - *Is social media good or bad?*
 - *The most memorable experience of my life*
- Dy letra rekomandimi nga mësues apo mentorë që i njohin nxënësit nga afër. Letra duhet të dërgohet me e-mail, direkt nga mësuesi/mentori, në adresën bursajorgjijajcari@gmail.com
- Për detaje mbi formatin e letrave të rekomandimit dhe informacionin që ato duhet të përmbajnë, vizitoni www.LyhnidaFund.com
- Fotokopje të diplomave ose çertifikatave nga aktivitete të ndryshme jashtëshkollore ose veprimtari vullnetare ku nxënësi ka marrë pjesë

Kriteret bazë për akordimin e bursës:

- Performanca akademike
- Intervistë e shkurtër online me aplikantët
- Pjesëmarrja në aktivitete ekstrakurrikulare
- Letra e motivimit / Eseja argumentuese

Ku mund të aplikoni:

Aplikimet e plota duhet të dërgohen në adresën e e-mailit bursajorgjijajcari@gmail.com, brenda datës **15 maj 2023**. Të gjitha materialet duhet të dërgohen vetëm në një dokument PDF sipas rendit kronologjik tek "Dokumentacioni i nevojshëm". Për çdo pyetje apo informacion të mëtejshëm na shkruani në adresën e e-mailit bursajorgjijajcari@gmail.com

Për më tepër informacion drejtoheni tek www.LyhnidaFund.com

Kriteret e vazhdueshmërisë së bursës:

Nxënësi/nxënësja fitues/fituese duhet të raportojë nëpërmjet një letre, rreth 300 fjalë, për ecurinë e tij/saj në shkollë dhe aktivitetet që ai/ajo i mendon të arsyeshme për t'u përmendur. Për këtë pjesë do të kontaktoheni nga stafi ynë gjatë vitit shkollor.

